



---

**VENDIM**

**Nr. 98 Datë 15.12.2009**

**PËR  
PËRCAKTIMIN E TARIFËS TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË  
ELEKTRIKE NGA OSSH SH.A. PER PERIUDHEN 1 JANAR – 31  
DHJETOR 2010**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa b; 9; 26 pika 1; 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 15; 20 dhe 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s Nr.21, datë 18.03.2009, Vendimit nr.79, datë 26.06.2008, “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës së shpërndarjes së energjisë elektrike”, Vendimin Nr. 74, date 12.10.2009 te Bordit te Komisionereve te ERE-s “Per fillimin e procedurave per percaktimin e tarifes se shperndarjes se energjise elektrike nga OSSH sh.a. per vitin 2010, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 15 .12.2009, pasi shqyrtoi aplikimin e OSSH sh.a për përcaktimin e tarifës të shpërndarjes së energjisë elektrike per vitin 2010, si dhe relacionin e Grupit te Punes te ERE-s,

**Vendosi :**

1. Tarifa e shpërndarjes së energjisë elektrike për OSSH sh.a për periudhen 1 Janar – 31 Dhjetor 2010 do te jete 5.70 leke/kWh per klientet tarifore.
2. Tarifa e shpërndarjes së energjisë elektrike për OSSH sh.a per Klientet e Kualifikuar dhe Furnizuesit e Kualifikuar te jete sipas vendimit te Bordit te Komisionereve te ERE-s Nr.20 date 14.02.2008.
3. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e OSSH sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.



---

Votimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s për,

**VENDIMIN**  
**Nr. 98 Datë 15.12.2009**

**PËR**  
**PËRCAKTIMIN E TARIFËS TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË**  
**ELEKTRIKE NGA OSSH SH.A PERUDHEN 1 JANAR – 31 DHJETOR**  
**2010**

Anëtarët e Bordit

	Pro	Kundër
Bujar Nepravishta	_____	_____
Entela Shehaj	_____	_____
Ardian Haçi	_____	_____
Abaz Aliko	_____	_____
Shkëlqim Bozgo	_____	_____